

VENDIM
Nr. 702, datë 10.10.2012

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
SHKODËR-HANI I HOTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, e të nenit 8 të ligjit nr. 9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkodër-Hani i Hotit.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për objekte dhe kultura bujqësore, me një vlerë të përgjithshme prej 77 664 466 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh.

3. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 77 664 466 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 1 130 500 (një milion e njëqind e tridhjetë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Shpronësimi të fillojë më 15.10.2012.

6. Pronarët e objekteve, të përmendur në listën bashkëlidhur këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit, i cili do të konfirmohet zyrtarisht nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive, si dhe pasi të kenë paraqitur të plotë dokumentacionin e pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

7. Pronarët e objekteve, të përmendur në listën bashkëlidhur këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces legalizimi”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

8. Pronarët e objekteve, të përmendur në listën bashkëlidhur këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja/proces gjyqësor për mbivendosje”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës, pas regjistrimit të këtij vendimi pranë ZVRPP-së, fakt, i cili do të konfirmohet zyrtarisht nga ZVRPP-ja, si dhe pasi të kenë paraqitur të plotë dokumentacionin e pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

9. Pronarët e objekteve, të përmendur në listën bashkëlidhur këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja/barrë hipotekore” dhe “Konfirmuar nga ZVRPP-ja/barrë mbi pasurinë”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të jetë hequr barra përkatëse, fakt i cili do të konfirmohet zyrtarisht nga ZVRPP-ja, si dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

10. Pronarët e objekteve, të përmendur në listën bashkëlidhur këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

11. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikave 6, 7, 8, 9 dhe 10 të

këtij vendimi.

12. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimeve, që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

13. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

14. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha